VENDIM
Nr.75, datë 26.10.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3 pika 3, nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 26 pika 1 shkronja "a", nenit 57 pikat 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 58 pika 1 dhe nenit 66 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" miratuar me vendimin nr.71, datë 14.10.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, pika 2, shtohet shkronja "k", me përmbajtjen e mëposhtme:

"...k. "Haircut" është përqindja me të cilën pakësohet vlera e aktivit likuid për qëllime të përllogaritjes së treguesit të likuiditetit, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.".

b) Në nenin 19, pika 3 ndryshon si më poshtë:

"...3. Banka përllogarit dhe siguron në çdo kohë respektimin e treguesit të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra:

a) në monedhën kombëtare (lekë) dhe në monedhë të huaj në nivelin minimal 20 % (njëzet për qind); dhe

b) në total në nivelin minimal 25 % (njëzet e pesë për qind).".

c) Në nenin 19, pika 4, shkronja "b" ndryshon si më poshtë:

"....b. llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;".

d) Në nenin 19, pika 4, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

"... 4. Aktivet e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g", "k", "l" dhe "m" konsiderohen aktive me likuiditet të lartë.".

e) Në nenin 19, pika 6, në fund të fjalisë së parë, pas fjalës "vit" shtohet shprehja e mëposhtme:

"... përveç letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes, si dhe të depozitave nga të tretë të bllokuara si kolateral/garanci në bazë të një marrëveshjeje të caktuar me bankën.".

f) Në nenin 19 shtohen pikat 5 dhe 6, respektivisht me përmbajtjen e mëposhtme, ndërkohë që pikat 5, 6 dhe 7 ekzistuese rinumërohen përkatësisht 7, 8 dhe 9:

"...5. Të gjitha aktivet likuide të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, do të përfshihen si të tilla vetëm në rastin kur mbi to nuk ekziston asnjë marrëveshje ose angazhim, i cili kufizon aftësinë e bankës për t'i zotëruar ato lirisht dhe në mënyrë të pavarur në rast nevoje, aktualisht dhe në të ardhmen.

...6. Bankat përfshijnë në treguesin e aktiveve likuide, zërat e përcaktuar në shkronjat "h", "i", "j", "n" dhe "o" të pikës 4 të këtij neni, duke përdorur *haircut-et* e përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Klasifikimi (rating) i kundërpartisë jorezidente sipas S&P ose të barasvlershëm me të	Haircut
1.	mbi BBB-*	0%
2.	BB+	10%
3.	BB	20%
4.	BB-	30%
5.	B+	40%
6.	B	50%

7.	B-	60%
8.	nën CCC+**	100%

Shënim sqarues: * përfshirë BBB-; **përfshirë CCC+.”.

g) Neni 20, pikat 1 dhe 3 riformulohen si më poshtë:

“....1. Bankat paraqesin në fund të çdo muaji në Bankën e Shqipërisë, formularët e përcaktuar në aneksin 2 të kësaj rregulloreje. Bankat respektojnë kufirin e treguesit të përcaktuar në nenin 19, paragrafi 3, shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj rregulloreje dhe raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë në rast të mosrespektimit të tij.

...3. Banka e Shqipërisë, kur konstaton situata të vështira të likuiditetit ose kur ajo e gjykon të arsyeshme, mund të kërkojë informacion më të zgjeruar dhe më të shpeshtë, si dhe mund të vendosë kërkesa dhe norma më kufizuese të përkohshme për administrimin e rrezikut të likuiditetit sesa ato të parashikuara në këtë rregullore, për banka individuale. Në këto raste, bankat sigurojnë nëpërmjet strukturave përkatëse një komunikim sa më efektiv dhe informacion të plotë sipas kërkesës së Bankës së Shqipërisë.”.

h) Në nenin 20 shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“...4. Bankat raportojnë në baza javore në Bankën e Shqipërisë, parashikimet për flukset hyrëse dhe dalëse të parasë, sipas përcaktimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje.”.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani